

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS PËR SIGURIMIN NGA VJEDHJA

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kushtet e Përgjithshme të kontratës për Sigurimin nga Vjedhja, këtu më poshtë do të quhen shkurtimisht "Kushtet e Sigurimit". Shoqëria e Sigurimeve "ATLANTIK", këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "Siguruesi". Personi fizik ose juridik, interesi pasuror i të cilit do të mbulohet sipas këtyre Kushteve të Sigurimit nga Vjedhja, këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "I Siguruari". Kontrata për Sigurimin nga Vjedhja, e lidhur midis Siguruesit dhe të Siguarit, këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "Polica e Sigurimit".

OBJEKTI I SIGURIMIT

Siguruesi ofron Sigurimin nga Vjedhja për objektet e mëposhtme:

- **paisje e sende shtepiake** - bashkësia e mobiljeve, paisjeve e sendeve shtepiake;
- **makineri e pajisje** - pajisje, makineri, impiante të lëvizshme, veglat dhe pjesët ndërrimit e bazamentet përkatëse;
- **pajisje zyre** - bashkësia e mobiljeve, makinave, veglave e orendive që përbëjnë pajimet normale të një zyre, ose që i shërbejnë përmbushjes normale së një veprimtarie tregtare apo profesionale, si dhe impianteve të parandalimit e alarmit, kasafortat, raftet e
- sigurimit e të përforcuara, blloqet e kasetave të sigurimit (përrjashtuar përmbajtjet përkatëse), përrjashtuar sa treguar në përcaktimin e mallrave, sendeve me vlerë, objekteve të vlefshme e letrave me vlerë;
- **mallra** - mallra, lëndë të para, prodhime gjysëm të gatshme, lëndë rezervë e materiale konsumi, amballazhe të brendshme e të jashtme, përrjashtuar sa treguar në përcaktimin e sendeve me vlerë, objekteve të vlefshme e letrave me vlerë;
- **objekte të vlefshme** - kuadro pikturë, skulptura, objekte arti që nuk janë mobilje, peliçe, objekte argjendi, tapete e sixhade, përrjashtuar sa treguar në përcaktimin e sendeve me vlerë e letra me vlerë;
- **sende me vlerë** - gurë të çmuar, metale të vlefshme (ar e platin) të përrpunuar ose jo, objekte me metal të vlefshëm e perla natyrale;
- **letra me vlerë** - kartmonedha, tituj krediti, obligacione e lloje të tjera të letrave me vlerë.

Objektet që do të sigurohen do të përcaktohen në Formularin e Kërkeses për Sigurimin nga Vjedhja dhe në listën e objekteve bashkëngjitur Polices së Sigurimit. I Siguruari mund të sigurojë pranë Siguruesit pasuri që e ka në pronësi të tij ose në çdo formë tjetër të pronësisë me kusht që të ketë një kontratë të rregullt me pronarin e pasurisë apo të sendit.

RREZIQET E SIGURIMIT

Siguruesi dëmshpërblen të Siguarin për humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e objekteve të siguruar që rrjedhin nga vjedhja, si dhe veprimet në tentativë gjatë kryerjes së saj si rrjedhojë e futjes në lokalin ose banesën e siguruar nëpërmjet:

- a. dhunimit të mjeteve mbrojtëse të jashtme me anë të thyerjes, shqyerjes, përdorimit të çelësave levë ose veglave të tjera të ngjashme me to;
- b. rrugëve jo të zakonshme, që kërkojnë kalimin e pengesave ose të mbrojtëseve duke përdorur mjete artificiale ose aftësi të veçanta vetjake;

Në se për të gjitha ose një pjesë të sendeve të siguruar në Policën e Sigurimit janë parashikuar mjete mbrojtëse të veçanta të brendshme, Siguruesi ka detyrim vetëm nëse autori i vjedhjes, pasi të jetë futur në lokal ose banesë me një prej mënyrave të sipërmendura, i ka dhunuar mjetet mbrojtëse me mënyrat e treguara në nenin 4, pika a.

Sigurimi nga Vjedhja mbulon vjedhjet dhe dëmtimet që pëson i Siguruari sipas nenit 4, pikat "a", e "b", me kusht që të jenë lënë gjurmë të cilat mund të përdoren si provë dhe që marrja e sendeve të vjedhura të bëhet pas mbylljes së lokalit ose banesës.

VLERA DHE SHUMA E SIGURUAR

Vlera e sigurimit do të jetë:

- a. për paisje dhe sende shtëpiake, vlera e zëvendësimit që do të konsiderohet vlera për t'u paguar për blerjen ose prodhimin e objekteve të të njëjtit tip dhe cilesi në një gjendje si të reja, cilado qofte shuma me e ulet;
- b. për makineri dhe pajisje dhe pajisje zyre:
 - vlera e zëvendësimit;
 - vlera aktuale, që do të jete e barabarte me vlerën e tyre të zëvendësimit minus një zbritje në përputhje me gjendjen e tyre, në veçanti me shkallen e amortizimit;
 - vlera e tregut, që do të jete e barabarte me çmimin e mundshëm të shitjes së tyre ose vlerën e materialit që mund të perfitojë i Siguruari nga shitja e pjesëve të tyre;
- c. për prodhimet e gatshme e gjysëm të gatshme, mallra, objekte të vlefshme e sende me vlerë do të jetë çmimi i blerjes së tyre ose vlera për prodhimin me të njëjtin lloj dhe cilesi, cilado qofte shuma me e ulet;
- d. për letrat me vlerë, vlera e tyre nominale por jo me e lartë se vlera e tregut.

Shuma e siguruar, si rregull, do të jetë e barabartë me vlerën e sigurimit. Baza mbi të cilën do të percaktohet shuma e siguruar do të vendoset në Policën e Sigurimit.

- a. Për paisje e sende shtëpiake, makineri e pajisje, pajisje zyre, objekte të vlefshme e sende me vlerë:
 - Shuma e siguruar si rregull do të jete e barabarte me vlerën e zëvendësimit të tyre;
 - Në rast të veçanta kur një makineri ose grup makinerish ose paisjesh nuk mund të përdoren më ose nuk janë të përdorshme për qëllimin e të Siguarit, shuma e siguruar do të jete vlera e tregut.
- b. për mallrat, lende të para etj.;
- Shuma e siguruar do të jete e barabarte me vlerën maksimale të tyre, e cila përfaqson vlerën maksimale të mundshme të mallrave të depozituara, deklaruar me shkrim nga i Siguruari.
- Në rast të veçanta, shuma e siguruar do të jete e barabarte me vlerën mesatare të tyre, e cila përfaqson vlerën mesatare që i Siguruari parashikon të ketë gjatë vitit, deklaruar me shkrim nga i Siguruari.

Nuk do të mbulohen në sigurim vlerat e rralla historike të disa objekteve të veçante.

Në rast të Sigurimit "në baze të rrezikut të parë", që do të deklarohet shprehimisht në Policën e Sigurimit, shuma e siguruar do të përfaqësojë një pjesë të vlerës së plote dhe Siguruesi do të paguajë në rast deri në këto shume të siguruar, duke mos zbatuar kushtin e nënsigurimit.

Primi i sigurimit do të jete me i lartë nga ai i llogaritur për sigurimin në baze të vlerës së plote.

PJESA E ZBRITSHME

Në rastet e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit do të zbatohet pjesa e zbritshme dhe/ose franshize. Për çdo rast deri ose humbje Siguruesi do të zbrese nga demshperblimi i llogaritur pjesën e zbritshme të percaktuar në Policën e Sigurimit në shume absolute ose në përqindje. Siguruesi nuk do të paguajë demë të veçanta që janë nën shumën e percaktuar si franshize në Policën e Sigurimit. Masat e pjesës së zbritshme dhe franshizes do të percaktohen në Policën e Sigurimit.